



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

---

**Njoftim Paraprak Përqendrimi**

Rasti: Përfitim Kontrolli Kastrati Sh.a / Auto Star Albania Sh.a

Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Kontratës së Shitjes së Aksioneve” e nënshkruar midis palëve Kastrati Sh.a (në cilësinë e Blerësit) dhe Auto Star Albania Sh.a (në cilësinë e Shitësit), më datë 17 Gusht 2015, me objekt përfitim e kontrollit mazhoritar mbi shoqërinë Auto Star Albania Sh.a nga shoqëria Kastarti Sh.a me anë të transferimit të 75% të aksioneve nga Shitësi tek Blerësi.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Kastrati SH.A** : është një shoqëri shqiptare aktive në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve, etj.;
- **Auto Star Albania SH.A**: është Distributori Gjeneral i Autorizuar për Shqipërinë i shoqërisë Mercedes Benz (Daimler AG) për tregtinë e automjeteve dhe të pjesëve të këmbimit të markës Benz.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me neni 10, pika 1) shkronja b), neni 12, pika 1) dhe 2 , pika 1) shkronja a) të Ligjit nr. 9121, date 28.07.2003, “Per mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar).

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**